

SËMUNDJET INFEKTIVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME



Dr. Abdul-Hamid El-Kudah

Përktheu: Elona MUÇA

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Parathënie

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi mësuesin e njerëzimit, profetin Muhammed (alejhis-selam), familjen e tij, shokët e tij, dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij.

Pyetje të shumta me tematikë, mbi sëmundjet infektive seksuale, na drejtohen drejtpërsëdrejti në ligjeratat dhe leksionet që mbajmë, apo nëpërmjet rrjeteve sociale. Grupet që na drejtohen më së shumti me pyetje janë të rinjtë, dhe çiftet bashkëshortore si meshkujt ashtu edhe femrat. Këto pyetje bazohen, në gjetjen e mënyrave për vetëkontrollimin e epsheve, mbi të kuptuarin saktë, të sëmundjeve infektuese seksuale, të cilat shkaktohen si pasojë e marrëdhënieve jashtmartesore dhe homoseksuale. Fatkeqësisht, duke menduar se këto tematika nuk trajtohen në bisedat fetare ndërmjet muslimanëve, të rinjtë kërkojnë dhe i marrin këto informacione nëpërmjet internetit.

Për shkak të rëndësisë së kësaj teme, kureshtjes dhe interesit të rinisë për trajtimin e tyre në jetën e përditshme, u pa e arsyeshme që nëpërmjet projektit “Të mbrojmë rininë nga sëmundjet infektive seksuale” të përcjellim informacionin e nevojshëm, për të ndihmuar jo vetëm rininë por edhe njerëzimin në tërësi.

Sot, vemë re, se rinia në mbarë botën, po ballafaqohet me fenomene të tilla si imoraliteti, vrasjet, dhuna, përdhunimi, kënaqësitë e shthurura seksuale, që udhëhiqen nga njerëz, që ndjekin rrugën e shejtanit. Është detyrë e të gjithëve, që t'i këshillojmë të rinjtë dhe mbarë njerëzimin, për të shpëtuar shoqërinë e për t'i zgjuar ata nga bataku ku kanë rënë.

Qëllimi i këtij libërthi “Pyetje dhe përgjigje” rreth sëmundjeve infektive seksuale, është që ai të jetë sa më i qartë dhe i thjeshtë, për t'u përthithur nga lexuesit, të jetë i dobishëm dhe orientues, për të ditur se si të largohen njerëzit, nga veprat e shëmtuara, viktimë e të cilave ka rënë rinia dhe shoqëria sot. Kjo përpjekje bëhet për të fituar kënaqësinë e Zotit të Madhëruar dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut të cilin e kemi amanet përpara Zotit, në mënyrë që njeriu i shëndetshëm t'i shërbej mbarë shoqërisë.

Falenderimet i takojnë Zotit të botërave.

Dr. Abdul Hamid El-Kudah.

Drejtori ekzekutiv i projektit “Mbrojtja e rinisë” i Organizatave Botërore Islame të Mjekësisë.

Fjala e përkthyesit

Falënderoj Allahun e Madhëruar që më bëri pjesë e përkthimit të këtij libërthi, dobiprurës për shoqërinë shqiptare dhe më gjerë!

Jam e nderuar dhe e lumtur që nëpërmjet këtij punimi, të shpreh mirënjohjen time për punën fisnike të mjekut të nderuar Abdul Hamid El-Kudah, i cili ma besoi mua këtë përkthim.

Dr. Abdul Hamid El-Kudah lindi më 1 janar 1946 në Jordani. Ai është një nga figurat më të njohura botërore në fushën e mjekësisë. Studimet universitare dhe pas universitare i ka kryer në fakultetin e mjekësisë në Universitetin e Karaçit, Pakistan. Njëkohësisht ka mbrojtur masterin dhe doktoraturën në Fakultetin e Mjeksisë në Universitetin e Mançesterit në Britani, ku është specializuar për ekzaminimin e sëmundjeve bakteriale. Dr. El-Kudah ka punuar si këshilltar në Fakultetin e Mjeksisë në Mançester, si ekzaminues i analizave mjekësore në departamentin e sëmundjeve në Jordani, si dhe drejtor i laboratorit mjekësor të ekzaminimit të sëmundjeve. Gjithashtu, ai ka punuar si profesor në Fakultetet e Mjeksisë në Jordani, dhe si specialist në Unionin Botëror të Universiteteve të Mjekësisë në vendet Islame (FIMA).

Dr. El-Kudah Ka botuar shumë libra në fushën e mjekësisë, si dhe artikuj shkencorë të botuar në revistat më prestigjioze bashkëkohore. Aktualisht është drejtor ekzekutiv i projektit “Mbrojtja e rinisë” që zbatohet nën kujdesin e Organizatave Botërore Islame të Mjeksisë.

Temat e trajtuara në këtë punim, janë aktuale, delikate dhe problematike për ambientin shoqëror ku ne jetojmë.

Nëpërmjet këtyre temave doktori i nderuar Abdul Hamid El-Kudah, synon të edukojë brezat dhe shoqërinë, me baza të shëndosha fizike dhe edukativo-morale.

Faktet dhe statistikat e përmendura në këtë material, e informojnë lexuesin me sëmundjet e ndryshme seksuale, transmetuese, infektuese që vijnë si rrjedhojë e pasioneve të shthurura.

Këto tema është e mira të trajtohen dhe të publikohen në mënyrë që njerëzit të mos bien pre e gabimeve që është vështirë të rikuperohen.

Temat e këtij libërthi sjellin tek lexuesi, fakte e statistika të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) si edhe nga Qendrat e Kontrollit dhe e Parandalimit të Sëmundjeve (CDC).

Shpresojmë që me përkthimin nga gjuha arabe të këtij materiali, të kemi arritur kënaqësinë e Zotit të Madhëruar dhe ky libërth të jetë një rizgjim i ndjenjave njerëzore në dobi të shoqërisë.

Elona Muça.

Kuptimet e simboleve të përdorura

STIs: Infeksionet seksualisht të transmetueshme që njihen ndryshe edhe si Sëmundje seksualisht të transmetueshme. Këto janë infeksione që zakonisht përhapen nga marrëdhëniet seksuale, veçanërisht nga marrëdhëniet vaginale, seksi anal dhe ai oral.

HIV: Virusi i mungesës së imunitetit njerëzor. Ky virus prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut, duke e lënë atë të pa mbrojtur nga infeksionet dhe nga disa lloje kanceri.

AIDS: Sindromi i përvetësuar nga mungesa e imunitetit. (SIDA).

HPV: Virusi njerëzor Papilloma. Ky virus shkakton infeksion në rrugët gjenitale.

WHO: Organizata Botërore e Shëndetësisë. (OBSH).

CDC: Qendrat për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve.

Fakte dhe statistika mbi STIs, HIV & AIDS

Të dhënat e paraqitura në këtë punim, janë nxjerrë nga faktet dhe statistikat e sëmundjeve të tilla si HIV dhe AIDS që shkaktohen, nga marrëdhënie seksuale të ndaluara. Gjithashtu janë shtjeluar, mënyrat e infektimit dhe shkaqet e përhapjes së viruseve, në mënyrë drastike, në të gjithë botën.

Njohja e të rinjve me këtë lloj informacioni, do të hapë horizontin e të menduarit dhe kështu do t'u përgjigjen pyetjeve të ndryshme, që qarkullojnë në heshtje në mendjet e tyre. Gjithashtu do t'i ndihmoj të largohen, nga veprat që Zoti i Madhëruar i ka ndaluar, në mënyrë që mos të bien pre e sëmundjeve infektuese të tilla si STIs.

Njohuri mbi viruset e sëmundjeve infektive seksualisht transmetuese (STIs):

1. Sëmundjet infektive që merren nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, rrugëve vaginale, seksit anal dhe oral, si viruset, bakteriet, mykoplasma ose parazitë të ndryshëm, mund të shkaktojnë sëmundje tek personi, pa shfaqur asnjë simptomë.
2. Në të shkuarën, sëmundjet infektive që transmetoheshin nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, të ndaluara, emërtoheshin me epitelin "Sëmundjet e luleve". Ndërsa në terminologjinë romake këto quheshin "Perëndia e dashurisë" Venus.
3. Sipas WHO, shpenzimet vjetore për të ekzaminuar të infektuarit, nga sëmundjet seksuale STIs dhe AIDS (SIDA) në mbarë botën, e kalojnë shumën e 150 bilion dollarëve.
4. Pritshmëria për tu infektuar nga sëmundjet infektive STIs tek vajzat, të cilat kryejnë marrëdhënie seksuale, të ndaluara paramartësore është 4 herë më e lartë sesa të mbajë fetusin e një foshnje në mitër, për shkak të imoralitetit.
5. Kryerja e marrëdhënieve seksuale, me ose pa ejakulacion është shkak i transmetimit të disa mikrobeve infektuese, të sëmundjeve seksuale.
6. Puçrat, që shfaqen tek organet gjenitale, jo gjithmonë janë tregues i sëmundjeve infektuese seksuale, por ato mund të jenë tregues të pjekurisë. Ato njihen ndryshe edhe si "puçrat e rinisë".
7. Sipas të dhënave zyrtare nga WHO, çdo vit ekzaminohen 300 - 500 milion individë me sëmundjet infektuese seksuale të tilla si STIs, HIV, AIDS.
8. Gratë dhe foshnjat janë më të prirur për tu prekur nga infeksioni i këtyre sëmundjeve, krahasuar me burrat, pasi kohë zgjatja e infeksionit, është e vazhdueshme tek gratë. Ky infeksion transmetohet gjithashtu, nga gratë edhe tek fetusin që ato mbartin.
9. Që nga viti 1981 e në vazhdim janë shënuar më shumë se 40 milion vdekje në mbarë botën, si pasojë e prekjes nga virusi AIDS.

10. Në fillimet e shfaqjes së saj, Qendra e kontrollit të sëmundjeve (CDC), e quajti AIDS-n si “kanceri homoseksual”. Më pas e quajti GRID (Gay Related Immune Deficiency) pra mangësi imunitare e lidhur me homoseksualët. Por ky emërtim ndryshoi pas infektimit homoseksual të aktorit të njohur Rock Hadson. Sipas profesorit francez Luk Muntenih, i cili zbuloi virusin AIDS-it, aktori i bëri një vizitë të fshehtë profesorit Muntenih në institutin e tij laboratorik në Paris, ku Hadson i dhuroi institutit, 30 milion franga franceze me kusht, që të zbulohet ilaçi, për t` shpëtuar jetën, dhe njëkohësisht të mos demaskohet rasti tij në publik. Mirëpo, kërkimet shkencore nuk e ndihmuan atë, dhe kështu sëmundja evuloi derisa ai vdiq. Kur u përhap lajmi i vdekjes së Hadson, njerëzit i shtuan mallkimet ndaj homoseksualëve. Në vitin 1982 shoqata e homoseksualëve, i bëri presion botës përëndimore, duke deklaruar se askush nuk mund ta kundërshtojë lirinë personale, dhe se kjo është një e drejtë prej të drejtave ligjore të njeriut. Kështu emri i virusit nga “kanceri homoseksual” u ndryshua në AIDS (SIDA).

11. Në SHBA, numri i personave, që janë mbartës të një nga sëmundjet infektive seksuale STIs, arrin mbi 65 milion. Gjysma e këtyre personave, janë infektuar me sëmundje seksuale, para moshës 25 vjeç.

12. Virusi HPV (virusi njerëzor Papilloma), që shkakton kancerin në organet gjenitale, po përhapet dhe po zhvillohet më shpejt, në krahasim me sëmundjet e tjera seksuale.

13. Kënaqësia që arrihet nëpërmjet masturbimit, nuk e ndalon faktin, e të qenit i infektuar nga sëmundjet seksuale. Këtu mund të përmendim infeksionet e organeve gjenitale të shkaktuara nga lloje të ndryshme bakteresh HPV apo zgjebja dhe morrat në qimet e organeve gjenitale.

14. Morri i qimeve, të organeve gjenitale, është një insekt i vogël, i cili ushqehet me gjakun e njeriut. Me prezencën e qimeve në organet gjenitale ky insekt, mund të transmetohet tek partneri nëpërmjet marrëdhënieve seksuale. Sëmundja e morrit, të qimeve të organeve gjenitale, është mjaft e përhapur në vendet perëndimore, pasi ato nuk i pastrojnë qimet. Kështu ky parazit, hyri në listën e sëmundjeve infektive nëpërmjet organeve gjenitale. **Profeti Muhamed (alejhis-selam) ka thënë:** “ *Prej veprave të natyrshme, që duhet të bëjë njeriu janë pesë: synetllëku, pastrimi i qimeve të sqetullave, prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, pastrimi i qimeve në organet gjenitale*”. Transmeton (Buhari). Në një transmetim tjetër tek Muslimi, gjejmë se është transmetuar nga Enesi (r.a) i cili tregon se profeti (a.s) ka përcaktuar edhe kohën e kryerjes së këtyre veprave, *duke këshilluar që nuk duhet të lihen pa u kryer në më shumë se 40 ditë*.

15. Origjina e infeksionit nga STIs, janë akoma të pa qarta. Disa hulumtues, mendojnë se, disa mikrobe përshtaten me ambientin dhe zhvillohen me kohë, për shkakë të ndryshme, të cilat arrijnë të shkatërrojnë organet gjenitale. Kjo hipotezë, akoma nuk ka arritur në shkallën e një rezultati të mirfilltë.

- 16.** Sëmundjet infektive seksuale që kanë efekt nga kurat e mjekimit, janë të pakta në numër. Ndër to mund të përmendim, chlamydia (klamidia), gonorrhea (gonorre), syphilis (sifilisi) dhe trichomoniasis (trikomoniaza), mjekimi i të cilave bëhet me anë të një terapie intensive nën vëzhgimin e mjekut. Ndërsa viruset e STIs, që nuk kanë efekt nga kurat mjekësore janë: HPV, herpes, hepatiti B dhe HIV.
- 17.** Sëmundjet infektive të tilla si chlamydia, gonorrhea dhe syphilis, nëse lihen pa u kuruar mund ta çojnë njeriun drejt vdekjes ose sterilitetit, si dhe drejt shkatërrimit të shumë organeve. Shpesh këto bëhen shkak i aborteve të herë pas herëshme.
- 18.** Brenda një viti në mbarë botën, rrezultojnë të infektuar me trichomoniasis mbi 180 milion persona. Ndërsa në SHBA statistikatat tregojnë se ka mbi 7,4 milion raste, të infektuar me këtë sëmundje për gjatë një viti.
- 19.** Studiuesit në SHBA, e kanë klasifikuar sëmundjen e AIDS (SIDA)-s si një prej sëmundjeve të STIs që prej vitit 1981, duke përcaktuar se virusi është shfaqur në veri të Amerikës, nga personat hoseksualë të cilët ishin shpërngulur më përpara në këtë zonë.
- 20.** Shkenca ka vërtetuar se nëpërmjet seksit oral përhapen mbi dhjetëra infeksione, ndër të cilët është edhe virusi HIV.
- 21.** Mikrobi chlamydia gjendet në qelizat e njeriut. Ky është mikrobi më i përhapur sot në botë nga sëmundjet e STIs. Ai shkakton një seri anomalish dhe dhimbje të shumta, përpara ekzaminimit dhe mjekimit. Për gjatë një viti, janë ekzaminuar 400 milion të infektuar.
- 22.** Sipas WHO-së janë 150-200 milion persona në mbarë botën, të infektuar me gonorrhea, ku 50-70% e të cilëve janë të rinj.
- 23.** Disa shkencëtarë mendojnë, se, sëmundja e AIDS-it e ka filluesën nga majmunët në Afrikë (majmuni jeshil në Zaire), dhe në fillimet e shekullit XX u transmetua tek njerëzit. Gojëdhanat thonë se, disa gjuetarë kanë kapur një majmun të infektuar me STIs. Megjithatë afërsisht mbi 10 hipoteza mbeten të pa sqaruara, deri tani, mbi origjinën e shfaqes së AIDS-it.
- 24.** Rezultatet e pasqyruara nga CDC tregojnë se, 20 milion persona në SHBA janë të infektuar me HPV. Ky virus shkakton kancerin në qafën e mitrës, në gojë, në buzë dhe në fyt. Ai nuk ka kurim përveçse nëpërmjet ndërhyrjeve me kirurgjikale.
- 25.** Në SHBA ekzaminohen afërsisht 6.2 milion raste të infektuar me HPV çdo vit. Shumica e këtyre rasteve nuk përbëjnë problem shëndetësor që të çojë në shtrimin e pacientëve në spital. Sipas WHO, rezulton se 290 milion gra janë mbartëse të këtij virusi, pa deklaruar tek të tjerët, për atë çfarë ato mbartin.
- 26.** Disa shtame të bakterieve të virusit HPV mund të çojnë në infektim të përhershëm duke shkaktuar më pas kancerin e gojës, fytyrës apo të qafës së mitrës.

27. Ka një vaksinë parandaluese, për disa lloje të bakterieve të virusit HPV. Ajo injektohet tre herë, brenda një periudhe kohore gjashtë muajore. Vaksina është shumë e kushtueshme. Vendet perëndimore këshillojnë vaksinimin e vajzave nga mosha 13-26 vjeç. Disa studime shkencore të kryera nga , Organizata e Mbrojtjes Shëndetësore Arabe, treguan se vendet arabe, nuk kanë nevojë për këtë vaksinë, për arsye se vajzat muslimane, gëzojnë shëndet të plotë dhe nuk janë të prekura nga këto sëmundje infektive, pasi ato, ruajnë virgjinitetin e tyre para martesës, duke zbatuar urdhërin e Zotit të Madhëruar në Kuran ku thotë: **“ Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtetë ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe“**. (Suretu Isra: 32).

28. Sipas një raporti të CDC-së përgatitur në 2013, në SHBA çdo vit rrezultojnë të infektuar me HIV rreth 50.000 raste.

29. Sipas të dhënave zyrtare në Jug të Afrikës, çdo vit, ekzaminohen 1500 raste të reja me virusin AIDS (SIDA). Fatkeqësisht në këto zona, ekzistojnë disa dogma se, një i infektuar me AIDS, nuk mund të shërohet veçse nëse përdhunon një vajzë ose një fëmijë. Kështu, në vend që të përpiqen të mjekohen, ata nëpërmjet këtyre dogmave, shtojnë numrin e viktimave.

30. Sipas statistikave të CDC rrezulton se, numri i burrave amerikanë me origjinë afrikane të infektuar me virusin chlamydia, është njëmbëdhjetë herë më i lartë, se burrat amerikan të racës së bardhë. Po kështu në vitin 2004 numri i burrave amerikan me origjinë afrikane, të infektuar me gonorrhea ishte nëntëmbëdhjetë herë më i lartë se burrat amerikan të racës së bardhë.

31. Amerikanët me origjinë afrikane përbëjnë 13% të popullatës së SHBA-së, ndërkohë gjysma e tyre janë të diagnostikuar me HIV ose AIDS.

32. Sipas CDC rrezulton se, edhe pse adoleshentët dhe të rinjtë nga 15-24 vjeç përbëjnë 25% të atyre që kryejnë marrëdhënie seksuale jo martesore, ato gjithashtu përbëjnë 50-75% të rasteve të diagnostikuara me STIs, HIV dhe AIDS në mbarë botën.

33. Çdo ditë në Amerikë diagnostikohen 12.000 raste të moshës adoleshente nga të dy gjinitë, me sëmundjet HIV dhe AIDS.

34. Kur një grua ekzaminohet me chlamydia për të parën herë, mundësia e sterilitetit tek ajo është 25%. Nëse ekzaminohet me të njëjtën sëmundje për herë të dytë atëherë, përqindja e sterilitetit rritet në 50%. Një goditje për herë të tretë nga këto sëmundje, bën që përqindja e sterilitetit te ajo rritet në 100%, si shkak i infeksioneve PID që janë mbledhur në mitër.

35. Në Afrikë rreth 50-70% e sterilitetit vjen si rezultat i infektimit PID, nga bakteriet e chlamydias dhe gonorrheas.

36. Edhe pse mjeksia ka përparuar shumë në konceptimin dhe informimin rreth këtyre sëmundjeve STIs, përsëri numri i të infektuarve është shtuar. Nga statistikat që ka nxjerrë WHO në vitin 2013, rezultojnë 499 milion të diagnostikuar me HIV.

37. Gratë lesbike, janë më tepër të ekspozuara ndaj sëmundjeve seksuale STIs, në krahasim me gratë e tjera që kryejnë imoralitet me meshkujt. Ato janë të prirura për tu infektuar me kancerin e qafës së mitrës, ndaj u këshillohet kontrolli mjekësor çdo vit.

38. Shumica e sëmundjeve seksuale STIs, mund të diagnostikohen pas një periudhe kohore të shkurtër pas infektimit, përveç atyre të infektuar me HIV.

39. Bakteriet e sëmundjeve seksuale STIs, nuk mund të transmetohen nëpërmjet notit nëpër pishina apo banjove publike. Ato transmetohen nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të drejtpërdrejta.

40. Bakteriet e sëmundjeve seksuale STIs, nuk mund të transmetohen nëpërmjet ujit, ajrit apo ushqimit. Ato transmetohen nëpërmjet takimit dhe fërkimit të lëkurës së trupit, me njëri- tjetrin gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale nëpërmjet seksit vaginal, anal ose oral.

41. Bakteriet e sëmundjeve STIs, nuk qëndrojnë as në dhé, e as në ajër. Shumica e bakterieve qëndrojnë tek trupat e njerëzve, të infektuar nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të ndaluara (haram).

42. Bakteriet e sëmundjeve seksuale nuk i dëmtojnë kafshët. Ato shkaktojnë sëmundje vetëm tek njerëzit. Këto sëmundje janë të disponuara si ndëshkim për veprat e degraduara, siç janë imoraliteti dhe homoseksualiteti. Ky argument bazohet në faktin se, ata që kryejnë marrëdhënie seksuale të lejuara, siç është jeta bashkëshortore ku bashkëshorti ruan nderin e tij dhe bashkëshortja ruan nderin e saj, ata nuk infektohen nga këto lloj bakteriesh të STIs. Duhet të theksojmë se, marrëdhënia seksuale në vetvete nuk është problematike, ajo bëhet problematike kur kryhet nëpërmjet imoralitet, marrëdhënieve homoseksuale apo nëpërmjet seksit oral, të cilat janë shkaktores të përhapjes së sëmundjeve infektive seksuale.

43. Ulçera e butë, që formohet nga sëmundjet seksuale në organet gjenitale, është vërtetë një infeksion i rëndë por, ka mundësi që të mjekohet. Ndërsa ulçera, e syphilis që është e ngurtë, shkakton shumë dhimbje tek burrat. Këto janë të përhapura kryesisht në vendet me temperatura të larta, siç janë zonat e Afrikës. Ato gjenden rrallë të përhapura në Perëndim.

44. Gjysma e rinisë dhe adoleshentëve amerikane, të cilët janë seksualisht aktivë, nuk e dinë nëse janë të prekur apo jo nga SIDA. Kjo për arsye se, ata të cilët i janë nënshtruar kontrollit shëndetësor dhe diagnostikuar janë më pak se çereku i tyre.

45. Prej sëmundjeve të STIs, që ndikon tek meshkujt më shumë se tek femrat është sëmundja e syphilis.

46. Banjot publike, që kanë qenë shumë të njohura në vitet 70-të, u kthyen në vendet më të përshtatshme për kryerjen e marrëdhënieve homoseksuale. Këto vende u bënë shkak i përhapjes së sëmundjes së SIDA-s (AIDS).

47. Seksi anal, që kryhet nga njëri prej partnerëve, duke futur gishtin në anusin e partnerit tjetër, është një nga mënyrat e infektimit me mikrobet e AIDS.

48. Tek personat e infektuar me HIV, pas një periudhe të shkurtër shfaqet SIDA. Gjithashtu, ka raste që sëmundja u shfaqet të infektuarve pas 10 vjetësh. Luhatje të tilla tek të infektuarit shkaktojnë depresion, çrregullime në të ushqyer dhe në kujdesin shëndetësor personal.

49. Personat të cilët vuajnë më shumë nga sëmundjet seksuale STIs janë ata të cilët kanë virusin SIDA. Ulçerat që ndodhen në organet gjenitale e lehtësojnë hyrjen e virusit SIDA në venat e gjakut.

50. Në vendet perëndimore, pretendohet se 1-4 adoleshentë, janë të infektuar me STIs. Ndërmjet të infektuarëve me sëmundjet seksuale, më i përhapur është virusi HPV.

51. Virusi HPV shkakton kancerin në gojë, fyt, gjuhë, buzë, bajame, tek ato persona që janë alkolist dhe të droguar.

52. Bakteriet e disa sëmundjeve seksuale si sifilisi, mund ta kalojnë plaçentën dhe të infektojnë fetusin që ndodhet në mitër. Bakteriet e sëmundjeve të tjera si gonorea, herpesi, klamidia, hepatiti B, mund të transmetohen nga nëna tek fëmija, gjatë kohës së lindjes së foshnjës. Ndërsa virusi SIDA mund të depërtojë në plaçentë gjatë kohës së shtatzanisë. Virusi mund të transmetohet edhe nëpërmjet qumështit të nënës tek fëmija. E tillë është sëmundja e fytit. Ajo nuk transmetohet si sëmundje trashëguese gjenetike.

53. Nëse gruaja shtatzanë është infektuar me STIs, mund të ndodhë një lindje e parakohshme, duke bërë që membrana mbrojtëse e plaçentës të çahet para kohe, gjë që shkakton infeksion të mitrës pas lindjes. Ka pasur raste kur fëmija ka lindur i vdekur. Gjithashtu, nëse fëmija lind i infektuar ai do të ketë humbje në peshë, infeksion në sy, mushkëri, mëlçi etj. Këto infeksione shkatërrojnë sistemin nervor tek foshnja

54. Simptomat, që mund të shfaqen nga STIs janë djegie dhe dhimbje gjatë urinimit, sekrecion të penisit. Dalja e sekrecioneve tek gratë, mund të ketë një erë të çuditshme. Mund të shfaqen enjtje rreth lëkurës së penisit ose vaginës, kruajtje, djegie, dhimbje rreth e qark penisit ose vaginës dhe dhimbje të fundit të barkut gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale.

55. Në çdo pesë amerikanë, një është i infektuar me herpes (20%), pjesa tjetër e popullatës nuk e dinë a janë të infektuar me këtë virus apo jo. Sipas disa rrezultateve, parashikohet se në vitin 2025, me herpes do të jenë të infektuar 40% e meshkujve dhe 50% e femrave.

56. Rrezikshmëria për tu infektuar me STIs, tek ata që përdorin mjete mbrojtëse (prezervativë) mund të jetë më e ulët por, kjo nuk garanton siguri të plotë. Siguria e plotë është vetëm në marrëdhëniet seksuale bashkëshortore të ndershme dhe të pastra.

57. “Syphilis” (sifilis) është quajtur kështu sipas një italian që ka vdekur në atë kohë nga mallkimi i sëmundjes së rrezikshme, e panjohur deri në atë kohë, pasi ky italian kishte kryer imoralitet brenda kishës.

58. Italianët dhe gjermanët e quajtën sëmundjen sifilis “Sëmundja franceze“, ndërsa francezët e quajtën “Sëmundja spanjolle“. Kështu, çdo vend fajëson tjetrin për origjinën e prejardhjes së kësaj sëmundje infektive, që shkaktohet nga imoraliteti. Disa historianë mendojnë se, sifilisi është shfaqur tek amerikanët në fillimet e periudhës së re. Ata thonë se Kristofor Kolombo është përgjegjës për transmetimin e sëmundjes në Europë, në udhëtimin e tij të njohur rreth e qark botës, me të cilin zbuloi Amerikën.

59. Sëmundja e sifilisit në Europë, në shekullin e 15-të, u mbart nga njerëz me pozitë; nga mbretërit, princat dhe njerëz të njohur. Kjo sëmundje preku afërsisht 10 milion persona. Shkrimtari i njohur Kat Raid shkroi librin “Sëmundje dhe ngjarje“ duke treguar histori të ndryshme impresionuese dhe duke veçuar se si ndikoi sifilisi tek njerëzit e mëdhenj të Europës.

60. Lloji më i mirë i mjeteve mbrojtëse nuk mund ta ndalojë infektimin nga bakteriet e STIs dhe virusit të SIDA-s. Bakteriet depërtojnë dhe hyjnë në trup nëpërmjet gojës apo injeksioneve që marrin të droguarit. Për të pasur informacion rreth këtyre mjete mbrojtëse është bërë një studim me temë “Mjete mbrojtëse (prezervativët) dhe seksi i sigurt“, të cilin mund ta gjeni në faqen “Mbrojtja e rinisë“ (www.qudah.com) ose në revistën Unioni Botëror i Organizatave Islame, e vitit 2014.

61. Nuk ka marrëdhënie seksuale të sigurt veçse në marrëdhëniet bashkëshortore të sinqerta. Ata nuk kanë nevojë për përdorimin e mjeteve mbrojtëse. Përhapja e prezervativëve dhe shpërndarja e tyre është një lloj inkurajimi për imoralitetin. Edhe pse përdorimi i mjeteve mbrojtëse është shumë i përhapur në Perëndim, ai përsëri nuk është zgjidhje e problemeve të sëmundjeve infektive seksuale (STIs).

62. Ekzistenca e këtyre marrëdhënieve seksuale problematike i përngjason marrëdhënieve seksuale tek kafshët, veçse kafshët nuk infektohen nga bakteriet STIs siç ndodh me njerëzit. Zoti i Madhëruar e nderoi njeriun nga të gjitha krijesat duke e zbukuruar atë me mendje, dërgoi për të profetë dhe të dërguar, libra të shenjtë për ta udhëzuar njeriun në rrugë të drejtë e për tu larguar nga veprat e ndaluara (haram). Allahu i Madhëruar nënshtroi çdo gjë për njeriun, duke e lënë atë të lirë të zgjedhë, në mënyrë që të përballë me sprovat në jetë. Ai i cili nuk diti ta vlerësojë mendjen, që ia ktheu shpinën Zotit, i konsideroi epsheet e tij si zot dhe ndoqi rrugën e shejtanëve, duke iu përkushtuar imoralitetit, homoseksualitetit dhe drogës, s’ka dyshim se bakteriet e STIs-it kanë zënë vend tek këta njerëz. Ata, me kryerjen e këtyre veprave të shëmtuara, kanë humbur këtë botë dhe tjetrën. Ndërsa kafshët, Allahu i Madhëruar nuk i ka nderuar me lirinë e të menduarit e të zgjedhjes, pasi ato nuk kanë mendje për të logjikuar se kush është e mirë e kush është e gabuar, prandaj dhe Zoti i ka ruajtur nga sëmundjet e STIs.

63. Emri i saktë i STIs është “Sëmundja e imoralitetit dhe homoseksualitetit”. Domethënë, sëmundjet e shkaktuara nga marrëdhënie seksuale të ndaluara, jashtë martesore. S’ka dyshim se çdo çift bashkëshortor kryen marrëdhënie seksuale por, ato nuk infektohen nga sëmundjet e STIs përderisa ata, i qëndrojnë besnikë njëri- tjetrit në jetën bashkëshortore.

64. Profesor Kevin Vinton, kryetar i shërbimeve shëndetësore botërore në Britani (2013), tërhiqte vëmendjen për të qenë të kujdesshëm për përballjen me një katastrofë botërore e cila do të shkaktohet nga homoseksualiteti. Numri më i madh i rasteve të përhapjes së SIDA-s në botë, është ndër homoseksualët.

65. Numri i të infektuarve midis homoseksualëve është tetë herë më i lartë se tek të infektuarit e gjinive të kundërta (maskull, femër). Ky numër është njëzet e tre herë më i lartë në vendet e varfëra, se në vendet e pasura.

66. Ndër shtetet e pasura, që kanë përqindje më e lartë të të infektuarve nga STIs, ndërmjet homoseksualëve, janë SHBA.

67. Seksi anal e transmeton virusin e SIDA-s tetëmbëdhjetë herë më shumë sesa marrëdhëniet seksuale vaginale. Praktikisht është vërtetuar se, mjekimet nuk mund t’i shmangin sëmundjet seksuale prandaj, duhet një punë ndërgjegjësuese që njerëzit të kuptojnë rëndësinë e shëndetit e të kujdesen për të, duke u larguar nga veprat e shëmtuara siç janë imoraliteti apo homoseksualiteti. Bazuar në gjendjen aktuale që po kalon njerëzimi, mediat e Ugandës publikuan një emision me temë “Vlerat, shëndeti dhe largimi nga marrëdhëniet seksuale të ndaluara.” Ky emision rrezultoi i suksesshëm pasi, numri i të infektuarve në vitin 1998, ndër të rinjtë e moshës 15- 19-të vjeç u ul me 75% dhe tek moshat 20- 24 vjeç u ul me 60%.

68. S’ka dyshim se imoraliteti, homoseksualiteti, seksi oral dhe narkotizmi janë përgjegjësit kryesorë të 90% të rasteve të infektimeve me STIs. Ndërkohë, dihet se të gjitha këto vepra janë të ndaluara nga të gjitha fetë qiellore.

69. Në Britani, brenda 12 muajve, është shtuar numri i të infektuarve me gonerrea (Gonorrhea) me 15%.

70. Në Britani, numri i të infektuarve me sifilis është shtuar me 9% më shumë nga viti 2012-13.

71. Drejtori ekzekutiv për mbështetjen e mjekimit të SIDA-s në Amerikë, Michel Seedeck, në ditën botërore të SIDA-s, në vitin 2013, ka deklaruar se:

- a) Nevojat vjetore për medikamente për mjekimin e SIDA-s arrijnë 24 miliard dollarë.
- b) Gjatë vitit 2006, numri i të infektuarve në Europën Lindore dhe në Azinë e Mesme është shtuar me 13%.
- c) Për vitin 2001, numri i të infektuarve në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut është shtuar me 100%.

72. STIs shkaktojnë më shumë se 30 lloje bakteriesh dhe virusesh të cilat, transmetohen nga të infektuarit tek viktimat që bien pre e imoralitetit, homoseksualitetit dhe seksit oral.

73. Në Amerikë, çdo vit infektohen nga STIs jo më pak se tre milion adoleshentë.

74. Projekti i SHBA në vitin 2007, për parandalimin e SIDA-s, ku u shpërndanë falas tre miliard e gjysmë qese me mjete mbrojtëse (kondomë), në të gjithë botën, për mbrojtjen nga këto sëmundje, fatkeqësisht nuk dha rezultat pozitiv pasi, numri i të infektuarve rrezultoi se ishte në rritje.

75. Është vërtetuar shkencërisht se, rrethprerja (synetllëku) tek meshkujt mund të uli në 60% infektimin nga SIDA (AIDS). Gjithashtu, rrethprerja është një tjetër faktor për mbrojtjen nga disa sëmundje të STIs, siç është herpes dhe HPV.

76. WHO në nëntor të vitit 2013 këto të dhëna:

- a) Më shumë se një milion njerëz infektohen, në ditë, me një nga sëmundjet e STIs. WHO, në vitin 2014 ka regjistruar 499 milion të rinj të infektuar.
- b) Më shumë se 500 milion njerëz infektohen, në vit, me një prej këtyre sëmundjeve: klamidia(Chlamydia), gonorrhea(Gonorrhea), sifilis (Syphilis).
- c) Më shumë se 35 milion njerëz, janë infektuar nga sëmundja seksuale herpes.
- d) Më shumë se 290 milion gra, janë infektuar nga HPV.
- e) Të infektuarit me SIDA (AIDS), po shtohen tri herë më shumë.
- f) Mikrobet e virusit gonorrhea (Gonorrhea), janë shumë të rrezikshme për tu mjekuar, 11% e medikamenteve që po përdoren, i shkojnë këtij virusi.

77. STIs, klasifikohen si sëmundje e zgjedhjes së lirë, pasi njeriu me dëshirën e tij, shkon drejt imoralitetit, homoseksualitetit, të cilat janë vatra të infeksionit. Mendja dhe llogjika e njeriut, janë argumente bindës për të kuptuar rrezikshmërinë e këtyre sëmundjeve por, njeriu duke u udhëhequr nga epshet e ndaluara, me vetëdijen e tij, bie në gropën e këtyre sëmundjeve infektuese. All-llahu i Madhëruar në suren Nur: 21, thotë: **“O ju të cilët besuat, mos shkoni gjurmëve të shejtanit, sepse kush ndjek gjurmët e shejtanit ai urdhëron për të shëmtuara e të irtuara, e sikur të mos ishte mirësia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush prej jush nuk do të pastrohej kurrë prej mëkateve, por All-llahu e pastron atë që don Ai, Allahu dëgjon dhe di.** Në suren Nisa ajeti 27, All-llahu i Madhëruar thotë: **“All-ahu dëshiron t’i pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi (nga rruga e drejtë)”**.

78. Të gjitha kërkimet shkencore që janë bërë për prodhimin e vaksinës kundër SIDA-s dhe disa sëmundjeve të tjera të STIs, kanë dështuar deri më sot. S’ka dyshim se, për këto kërkime shkencore janë shpenzuar miliarda dollarë.

Shkencëtarët janë ndanë në dy grupe. Njëri grup mbështet faktin se, duhet të vazhdojmë të bëjmë kërkime të mëtejshme derisa të arrijmë një rezultat. Ndërsa grupi tjetër mendon se, kjo përpjekje nuk do të çojë në asnjë rezultat serioz, duke argumentuar se kujdesi dhe mbrojtja e rinisë nuk bëhet nëpërmjet vaksinimit por, me edukimin, ndërgjegjësimin dhe inkurajimin e rinisë për të shkuar drejt martesës. Nëse supozojmë

se e gjetëm vaksinën e këtyre sëmundjeve, a t'i themi rinisë: -" Merrni këtë vaksinë dhe bëni çfarë të doni pasi jeni të mbrojtur nga SIDA?!"

Kështu, edukimi dhe inkurajimi i tyre për një martesë të shëndoshë është zgjidhja e natyrshme dhe e saktë. Nuk ka zgjidhje tjetër.

Profeti Muhamed (s.a.a.s) thotë: -*"Kush ka mundësi financiare le të martohet, pasi martesa është mburojë për shikimin, është mburojë për organet gjenitale. Ai i cili nuk ka mundësi atëherë le të aqjërojë, kjo do të jetë shpëtim për të (më e mirë për të).* Transmeton Buhariu.

79. Vendet perendimore kanë një slogan: *"God created Adam and Eve not Adem and Steve!"* D.m.th se, Allahu krijoi mashkullin dhe femrën dhe nuk krijoi dy meshkuj apo dy femra. Marëdhënia e shëndoshë dhe natyrale është ajo midis mashkullit dhe femrës. Kështu, homoseksualiteti është vepër e njerëzve djallëzorë që e praktikojnë atë. Kjo vepër na rikujton edhe një herë historinë e popullit të profetit Lut (a.s), që Zoti e ka përmendur në Kuran. Allahu e ndëshkoi këtë popull me një shkatërrim të dhimbshëm. Vallë, a do të ndalojnë njerëzit nga këto vepra të shëmtuara që sot janë me shumicë!? Kur të pendohen njerëzit, do të jetë shumë vonë!!

Allahu i Madhëruar në suren Enfal: 25, thotë: **"Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush por, edhe të mirët. Dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë"**.

80. Drejtori ekzekutiv për mbështetjen e mjekimit të SIDA-s (AIDS) në Amerikë, Michel Seedeck ka thënë: "Duhet të punojmë, që ta shfrytëzojmë SIDA-n si mjet politik, që nëpërmjet saj të ndodhin ndryshime në shoqëri. Ajo mund të shërbej, si ndërgjegjësim për shoqërinë, për pranimin e homoseksualizmit, duke i dhënë atyre liri veprimi, si një vepër e të drejtave të njeriut.

81. Papa Benedikti i 16-të ka deklaruar se, homoseksualiteti do t'i shkatërrojë marëdhëniet seksuale natyrale midis dy partnerëve me gjini të kundërt. Krye kardinali, që është njeriu i dytë në Vatikan, u befasua kur dëgjoi për vendimin që mori Irlanda, në vitin 2015, për legalizimin e martesës midis të njëjtës gjini. Ai tha: -" Kjo është një tronditje për njerëzimin dhe vlerat e tij, jo vetëm për të krishterët por për mbarë botën. Allahu i Madhëruar në suren Ankebut: 28- 30, thotë:

"(Dërguam) Edhe Lutin, i cili popullit të vet i tha: "Ju bëni aq punë të shëmtuar sa askush para jush nga tërë bota nuk e ka bërë. Ju jeni që kontaktoni me meshkujt, që sulmoni njerëzit në rrugë, që në vendtubimet tuaja bëni punë të ndyra". Përgjigja e popullit të tij nuk ishte tjetër veçse: "Nëse thua të vërtetën na sill dënimin nga Allahu." Ai (Luti) tha: -"O Zoti im! Më ndihmo kundër popullit të shthurur!".

Kështu, nëse njerëzit nuk zgjohen nga neglizhenca që i ka kapluar dhe drejtohen në udhë të drejtë, do të vijë shkatërrimi.

82. Disa nga çifutët pretendojnë se, shkak i homoseksualitetit vjen si rrjedhojë e trashëgimisë gjenetike tek homoseksualët prandaj, homoseksuali nuk duhet ndëshkuar për sjelljet dhe veprimet që kryen. Pas këtij pretendimi, në Austri u kryen kërkime shkencore të cilat vërtetuan se kjo hipotezë e çifutëve nuk është e saktë. Specialistët e kësaj fushe që arritën në përfundimin se homoseksualiteti nuk është vepër gjenetike si trashëguar, ishin jo myslimanë. Ata ishin specialistë nga e gjithë bota. Qëllimi i

çifutëve që e shtruan këtë hipotezë nuk qëndron vetëm në faktin për të përhapur veprat e shëmtuara midis njerëzve por, qëndron edhe në përpjekjen për ti bërë njerëzit dyshues në besimin e tyre tek Zoti. Pyetje të tilla si: **“Si mund të ndëshkohen në fenë Islame këto grupe njerëzish që janë homoseksualë pasi, ata janë të pafajshëm për veprat që kryejnë!?”**

Allahu i Madhëruar në suren Isra: 43, thotë: **“I pa të meta është Ai, Lartësia e Tij është më e madhe nga ajo që ata thonë”.**

83. Më 15.05.2015 u deklarua martesë e kryeministrit të Luksenburgut, Kesafiih Betül, me shokun e tij Güte Distinoi. Akti i kurorëzimit u nënshkrua nga kryetari i bashkisë së Luksenburgut, Ledy Bylver. Kryeministri i Belgjikës, Sharl Michel, i cili ishte pjesëmarrës në këtë ceremoni, pas përshëndetjes së tij falënderoi Luksenburgun duke thënë se, ai është pishtari udhëheqës në Europë, duke shpalosur kështu lirinë njerëzore pa kufi, e cila duhet të jetë pjesë e ligjit për të drejtat e njeriut!!

Sëmundjet seksualisht transmetuese infektuese (STIs)

Pyetje & Përgjigje.

Do paraqesim disa pyetje që na janë bërë gjatë konferencave, leksioneve dhe trajnimeve të mbajtura në vende të ndryshme të botës.

1. A mundet njeriu ta kuptoj që është infektuar me STIs?

- Jo, jo nuk mundet. Ka raste që të infektuarit me STIs nuk shfaqin asnjë simptomë. Këto raste janë më shumë tek femrat pasi, organi i saj gjenetal është i brendshëm dhe shumë i ndjeshëm. Gjithashtu, edhe burrat e infektuar me virusin klamidia (Chlamydia), nuk shfaqin ndonjë simptomë. E njëjtë është gjendja edhe me ata persona që janë infektuar me virusin SIDA (AIDS). Simptomat e tij nuk shfaqen menjëherë por pas një periudhe kohore 10 vjeçare pas infektimit.

2. A mundet të ketë shërim për të gjitha sëmundjet seksuale nëse përdorim mjekimin sipas rekomandimit të mjekut?

Jo. Jo nuk mundet. Akoma nuk është gjendur mjekimi i suksesshëm për shërimin nga sëmundjet e STIs. Edhe ato sëmundje të STIs që i nënshtrohen mjekimit, nuk mund të shërohen nga virusi për këto arsye:

- a) Vetëm 10% e të sëmurëve i nënshtrohen mjekimit të STIs. Sipas statistikave të OBSH-së, të infektuarit kanë frikë të shkojnë në spital për të bërë kontrollin shëndetësor, që të mos ekspozohet sëmundja e tyre tek shoqëria që i rrethon, sepse është turp.
- b) Mikrobet e këtyre viruseve janë rezistente ndaj trajtimeve të përdorura.
- c) Disa nga këto sëmundje janë të fshehta, ato nuk diktohen veçse duke ju nënshtruar kontrollit mjekësor.

3. A ka siguri përdorimi i mjeteve mbrojtëse (prezervativëve) për mos përhapjen e sëmundjeve seksuale?

Jo. Mjeti më i mirë për ndalimin e këtyre sëmundjeve është largimi 100% nga marrëdhëniet e ndaluara seksuale. Të mos harrojmë se, përhapja e sëmundjeve infektive seksuale mund të shkaktohet edhe nga prekjet dhe përkëdheljet e vendeve të infektuara, pa kryer marrëdhënie intime. Kështu, nëse p.sh kofshët e njeriut janë të infektuara me herpes, sëmundja mund të përhapet tek partneri i cili ka prekur këtë pjesë të kofshës. Ajo mund të transmetohet gjithashtu tek goja, sytë ose tek pjesa e anusit.

4. A janë prezervativët të pasigurt, për mbrojtjen nga sëmundjet e STIs?

Po... Mjete mbrojtëse janë të pa sigurta, për këto arsye:

- a) Në të shumtën e rasteve ato prishen shumë shpejt.
- b) Bien poshtë gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale.
- c) Nuk e mbrojnë infektimin që zhvillohet brenda organeve gjenitale. Gjithashtu, nuk mund të mbulojnë infeksionin që shfaqet në pjesën e sipërme të kofshës, pranë organeve gjenitale.

- d) Mjetet mbrojtëse prodhohen nga lëkura e deles nuk përcjell ndjeshmëri gjatë veprimeve dhe kontakteve mes çiftit.
- e) Mikrobet e këtyre sëmundjeve mund të transmetohen edhe nëpërmjet seksit oral.

5. A mundet që mikrobet që shkaktojnë sëmundjet e STIs, të hyjnë në trup vetëm nëpërmjet organeve gjenitale të femrës dhe mashkullit?

Jo. Mundet që bakteriet dhe viruset e këtyre sëmundjeve të hyjnë në trup jo vetëm nëpërmjet organeve gjenitale por edhe nëpërmjet gojës (seksit oral) rrugëve anale dhe në disa raste edhe nëpërmjet syrit. Virusi i SIDA-s mund të hyjë në trup nëpërmjet gjakut, nëse për injektim përdoret një gjilpërë e infektuar. Atëherë, mikrobi hyn në gjak nëpërmjet injektimit nga gjilpëra me ilaç ose nga gjilpëra me të cilën merret droga.

6. A mundet që adoleshentët, të kryejnë kontrollin mjekësor ndaj STIs dhe të mjekohen, pa i vënë në dijeni prindërit?

- Po. Çdo adoleshent mund të kryejë kontrollin mjekësor në klinikat e specializuara ku trajtohen kontrollet e analizave për sëmundjet STIs. Në SHBA, kontrolli mjekësor për adoleshentët dhe të varfërit ofrohet falas ose me një çmim modest.

7. A mund të infektohet njeriu me një nga sëmundjet e STIs nëpërmjet përshëndetjes me dorë me personin e infektuar, gjatë ecjes apo bashkëbisedimit me të?

- Jo...Pasi mikrobet e këtyre sëmundjeve, nuk transmetohen tek të tjerët veçse nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të tërthorta ose të drejtpërdrejta ose nëpërmjet gjilpërave të infektuara.

8. A janë sëmundjet e STIs një problem i ri për mjekët?

Duke ditur fillesat e shfaqjes së këtyre sëmundjeve nuk mund të themi se është diçka e re pasi, në fillimet e saj është quajtur “Sëmundja e lules“. Por, e reja në këtë çështje është fakti që numri i tyre është shtuar dhjetë herë më shumë sesa në fillimet e saj. Kështu që numri i të infektuarve me STIs çdo vit shkon 500 milion. Ky është një problem i vjetër por, që po shfaqet dhe përhapet në gjeneratat e reja.

Profeti Muhamed (s.a.a.s) na ka tërhequr vëmendjen para 1400 vitesh kur ka thënë: *“Kur të shfaqet imoraliteti në një popull dhe të bëhet ekspozimi i tij, veçse do t’ju ndëshkojë Zoti me sëmundjen e malarjes dhe fatkeqësi që nuk i ka ndëshkuar paraardhësit e tyre”*. (Transmeton Hakimi).

9. A shkaktojnë këto sëmundje probleme të rrezikshme shëndetësore dhe a të çojnë ato drejt vdekjes?

Po. Virusi HIV që i përket familjes së STIs, mund të shkaktojë probleme të rrezikshme shëndetësore. Virusi i SIDA-s prish sistemin imunitar aq sa e çon të infektuarin drejt vdekjes. Herpesi në rrugët gjenitale mund të shkaktojë verbimin e të infektuarit. Viruset

klamidia dhe gonorea mund të çojnë në sterilitet. Sifilisi shkakton prishjen e qelizave nervore të trurit dhe çon drejt vdekjes.

10. A mund të infektohen me këto sëmundje vetëm ata të cilët kryejnë marrëdhënie seksuale nëpërmjet vaginës apo rrugëve anale dhe seksit oral?

Jo. Fëmijët mund të infektohen me këto sëmundje gjatë procesit të shtatzanisë dhe atij të lindjes, ashtu si virusi i SIDA-s që mund të transmetohet nëpërmjet injeksioneve në gjak nga përdoruesit narkotik.

11. A mund të ketë pasoja personi i cili e vonon apo e neglizhon kontrollin shëndetësor dhe mjekimin, pasi e ka kuptuar që është infektuar?

Po. Mikrobet fillojnë të dobësojnë shëndetin dhe ta shkatërrojnë atë, që në momentin që infeksioni hyn në trup. Nëse neglizhohet kontrolli shëndetësor dhe mjekimi ndaj këtyre sëmundjeve atëherë, trupi dëmtohet aq shumë sa që edhe mjekimi nuk bën dobi. Gjithashtu, neglizhenca mund të shkaktojë infektimin e të tjerëve, pa e kuptuar edhe vetë personi.

12. A mund të parandalohet infeksioni nëse pas marrëdhënieve seksuale i lajmë menjëherë organet gjenitale?

- S`ka dyshim se pastërtia, është një faktor pozitiv por nuk është parandaluese për infeksionin. Larja ndihmon në daljen e lëngut të infektuar. Ky veprim e lehtëson infeksionin, por nuk e largon atë. Për atë që është i sëmurë me sifilis (Syphilis), mikrobet e tij, shpërbëhen kur bien në kontak me ujin dhe ajrin.

13. A mund të infektohem nëpërmjet puthjes?

- Po. Mundet që të gjitha mikrobet e sëmundjeve seksuale STIs, të transmetohen tek tjetri nëpërmjet puthjes.

14. A mundet që seksi oral të jetë më i sigurtë nga infektimi në krahasim me llojet e tjerave të marrëdhënieve seksuale?

Sigurisht që jo. Nëpërmjet seksit oral transmetohen mikrobet e sëmundjeve infektive të tilla si SIDA, sifilisi, herpesi, gonorea dhe lythet gjenitale. Këto lloj infeksionesh janë shkak i sëmundjeve kanceroze në gojë, gjuhë dhe fyt.

15. A mundet njeriu ta konstatojë veten e tij, se është infektuar me STIs brenda 2 – 5 ditëve pas infektimit?

Jo, nuk mundet. Njeriu paraprakisht nuk mundet ta konstatojë veten nëse është infektuar. Shumë prej këtyre mikrobeve nuk shfaqin asnjë simptomë tek i infektuari për muaj ose vite me rradhë, përveç mikrobeve të virusit gonorea, simptomat e të cilit shfaqen tri ose shtatë ditë pas infektimit. Atëherë njeriu e kupton se është infektuar.

16. A është informimi i partnerit tuaj gjëja më e rëndësishme, kur ti kupton veten që je infektuar me STIs ?

Jo, edhe pse kjo është e domosdoshme. Më e rëndësishme është kontrolli shëndetësor i menjëhershëm dhe trajtimi i infeksionit. Për aq kohë sa njeriu nuk e ekzaminon veten, ai është mjet transmetimi tek partneri tjetër.

17. Cilat janë mënyrat që ndikojnë në mos transmetimin e virusit të AIDS ?

- Kemi shumë mënyra në jetën e përditshme, që nëpërmjet tyre nuk transmetohet virusi SIDA (AIDS). Ato janë:
- Përqafimet.
- Puthja në faqe.
- Përshtëndetja me dorë.
- Marrja frymë e vetes së tij.
- Jargat.
- Kollitja.
- Djersa.
- Lotët.
- Kruajtjet gjatë aktiviteteve sportive.
- Ulja në vendet ku urinojmë dhe dalim në jashtëqitje. (WC)
- Enët e ushqimit.
- Gotat e ujit.
- Veshja e rrobave, qofshin ato të vjetra apo të reja.
- Larja nëpër pishina dhe dushe.
- Pickimi i mushkonjave.
- Pickimi i fluturave.

18. Si mund ta ndalojmë transmetimin e infeksioneve të STIs?

- Ndalimi i transmetimit të këtyre infeksioneve mundet të arrihet nëse ndjekim rregullat e mëposhtme:
 - a) Të përqëndrohemi vetëm tek ruajtja e marrëdhënieve intime bashkëshortore natyrale të singerta midis çiftit.
 - b) Ti themi stop imoralitetit.
 - c) Besnikëria midis bashkëshortëve.
- d- Informimi i nxënësve dhe studentëve, nëpërmjet leksioneve rreth sëmundjeve seksuale (STIs) dhe rrezikshmërinë e tyre, duke u treguar se cilat janë masat mbrojtëse.
- e- Ndalimi i transmetimit të virusit nga nëna tek foshnja, nëpërmjet marrjes së disa medikamenteve antivirus. Gjithashtu, nëna e infektuar nuk duhet t'i japë qumësht gjiri foshnjës së saj. Lindja me operacion është mënyra më e mire në këtë rast.

19. Si mund ta kuptoj që jam mbartës i viruseve të STIs?

- Mënyra e vetme për të treguar a je apo jo i infektuar është kryerja e analizave specifike për këto viruse.

20. Cili është ndryshimi ndërmjet mbartësit të SIDA-s (AIDS) dhe të infektuarit me SIDA (AIDS)?

Kur infektohesh me SIDA do të thotë se i nënshtrohesh kontrollit dhe sasia e infeksionit që ka hyrë në gjak është e vogël. Njeriu mundet të jetojë me të disa vite. Ndërsa mbartësi i virusit mund të mos e kuptojë se është i sëmurë pasi nuk ka asnjë simptomë mirëpo, ai mund të infektojë të tjerët pa e kuptuar. Kështu shtohet numri i të infektuarve. Virusi i SIDA-s i shkatërron qelizat shumë shpejt. Kështu, i infektuari mund të përballlet me sëmundje të tjera fizike për shkak të shkatërrimit të qelizave në gjak. Ndodh që përmirësimi i anës shëndetësore apo reagimi ndaj mjekimit dhe trajtimit të infeksionit, nuk jep rezultat të shpejtë. Mund të shfaqen disa infeksione të veçanta. Sa më shumë shtohet infeksioni aq më shumë shkatërrohet sistemi imunitar, aq sa nuk mund t'i rezistojë këtyre infeksioneve. Në këtë rast themi se personi është i sëmurë me SIDA.

21. Kur mund t'i marrë medikamentet antivirusale një person që është sëmurë me SIDA (AIDS)?

• Janë disa çështje, që duhet të merren seriozisht para se të përdorim medikamentet antivirusale. Personi i infektuar, në mënyrë që të ruaj shëndetin e tij, duhet të kujdeset për veten duke ju nënshtuar disa rregullave, të cilat janë:

- Të ushqehet mirë.
- Të merret me sport.
- Të largohet nga çdo gjë që e streson.
- Të largohet nga pirja e duhanit dhe alkolit.
- T'i nënshtrohet trajtimeve shëndetësore për çdo problem që i shfaqet.
- Të tregohet i kujdesshëm në menaxhimin e problemeve të përditshmërisë së jetës.

• Para se të fillojë marrjen e medikamenteve duhet:

- Të konsultohet me mjekun specialist, duke pasur parasysh anën e tij sociale, llojin e profesionit që ushtron pacienti dhe gjëra të tjera që janë të rëndësishme në jetën e të sëmurit.
- Kryerja e analizave laboratorike për të përcaktuar sesa është përqindja e rritjes së virusit, në mënyrë që të fillohet trajtimi.
- Pregatitja morale dhe shpirtërore e pacientit për faktin se i sëmuri duhet të marrë rregullisht mjekime, deri në fund të jetës së tij.
- Duhet t'i shpjegohet pacientit mënyra si duhet të merren këto medikamente dhe si ndikojnë ato në trupin e njeriut, duke i treguar se cilat janë efektet anësore të marrjes së këtyre medikamenteve.
- Të gjenden njerëz që ta mbështesin të sëmurin gjatë trajtimit të tij, në zonën ku ai banon, në mënyrë që të këshillohet me ata.
- Zbatimi i orarit të pirjes së medikamenteve duhet të jetë sa më korrekt, sipas orientimit të mjekut.

22. A ka ndonjë shpresë për shërimin e të infektuarve nga STIs?

Po. Mjekimi ekziston dhe shpresojmë të ketë shërim nga sëmundjet e STIs, pasi profeti Muhamed (s.a.a.s) ka thënë: - “Nuk ka zbritur Zoti një sëmundje, veçse ka zbrit për të

edhe mjekimin.” Transmeton Buhariu. Ndërsa në një transmetim tjetër nga libri i haditheve të imam Ahmedit gjejmë: - *“Nuk ka zbritur Zoti një sëmundje, veçse ka zbrit për të edhe mjekimin. Atë e gjen ai që është i ditur dhe e neglizhon ai që është i paditur.”* Kështu, ilaçi ekziston ndaj dhe hulumtimi i mjekëve për gjetjen e këtij medikamenti është në përpjekje e sipër dhe shpresojmë që, një ditë do të zbulohet. Në ditët e sotme, përparimi shkencor dhe i teknologjisë kanë dhënë rezultate të kënaqshme në trajtimin e të sëmurëve që vuajnë nga dobësimi i sistemit imunitar dhe nga virusi i SIDA-s, duke i mbajtur nën kontroll, njëllon si mbahen në kontroll të sëmurët nga diabeti apo nga tensioni. Vërtetë nuk është gjetur medikamenti shërues ndaj këtyre sëmundjeve por, duke marrë trajtimin e vazhdueshëm nën kontrollin e mjekut është arritur një stabilitet ndaj sëmundjeve, duke e marrë me pozitivitet faktin të “Jetosh me sëmundjen”.

- Të jetosh me sëmundjen dhe të jesh pozitiv do të thotë:
 - a) Të ruash veten që të mos e transmetosh virusin tek të tjerët.
 - b) Të ushqehesh mirë.
 - c) Mjekimi i menjëhershëm i sëmundjeve infektive oportuniste.
 - d) Të jesh i vendosur që do të kujdesh për shëndetin tënd.
 - e) Të jesh pozitiv për jetën dhe të jesh optimist ndaj mjekimit që merr.
 - f) Të marrësh pjesë aktive në grupet që i mbështesin ata që vuajnë nga STIs, në mënyrë që të përcjellësh tek ata energji positive dhe kurajo, duke shkëmbyer eksperiencë këshilluese se si të përballen me sëmundjen dhe si të jenë optimistë.
 - g) Të planifikojmë të ardhmen dhe të ndjekim qëllimet tona pozitive.

23. Përse martesë me katër gra (sipas dispozitave të shariatit) nuk është transmetuese e sëmundjeve të STIs, ndërsa imoraliteti është transmetuese?

Njerëzit, në bazë të kryerjes së marrëdhënieve seksuale klasifikohen në dy grupe. Grupi i parë janë ato që kryejnë marrëdhënie intime, natyrore, të lejuara midis bashkëshortëve, duke rrespektuar ruajtjen e ndershmërisë dhe besnikërisë ndaj njëri-tjetrit. Nëse bashkëshorti martohet me gruan e dytë, të tretë apo të katërt dhe të gjitha këto gra, janë besnike ndaj bashkëshortit të tyre dhe nuk e tradhetojnë atë dhe, njëkohësisht bashkëshorti është besnik ndaj grave të tij dhe nuk i tradhëton ato, atëherë nuk ka vend për sëmundje infektuese seksuale të STIs. Sikur ky raport të prishet midis të pestëve, qoftë nëse edhe njëri prej tyre të tradhëtojë, atëherë situata bëhet e rrezikshme për transmetimin e sëmundjeve seksuale infektive. Ndërsa grupi i dytë i njerëzve, janë ato që kryejnë imoralitet, sot janë me një grua, nesër me një tjetër dhe këto gra kanë shkuar më parë me burra të tjerë duke kryer imoralitet. Në këtë mënyrë, transmetimi i sëmundjeve infektive STIs përhapet tek të gjithë.

Ndaj edhe profeti Muhamed (s.a.a.s) na ka këshilluar duke na treguar që të jemi të kujdesshëm në kryerjen e marrëdhënieve seksuale duke thënë:

-“Nëse shfaqen në një popull paturpësitë (imoraliteti, homoseksualiteti) dhe ato bëhen publike, veçse ka për ta ndëshkuar Zoti atë popull me fatkeqësi dhe dhimbje, që nuk i ka sprovuar me to popujt para tij”. Transmeton Hakimi.

Prandaj, sa më të rregullta të jenë marrëdhëniet seksuale martesore, me qëllim që të fitojmë kënaqësinë e Zotit duke u larguar nga ato që Zoti na ka ndaluar, aq më e shëndoshë do të jetë shoqëria.

24. A mundet që në të ardhmen t'i kapërcejmë sfidat që kanë sjellë sëmundjet e STIs?

- Po. Përhapjes së sëmundjeve infektuese STIs, mund ti vendosim kufi, duke i shndëruar ato si lloje të sëmundjeve të rralla, nëse zbatojmë pikat e mëposhtme:
 - a) Të përmirësojmë rritjen e edukimit të brezave të rinj, duke mbjellë në zemrat e tyre farën e besimit që në vogëli.
 - b) Të mbështesim martesën e të rinjve, të cilët nuk e përmbajnë veten ndaj marrëdhënieve seksuale.
 - c) Thjeshtësimi i shërbimeve mjekësore, për çdo njeri i cili infektohet, duke përfshirë të gjitha shtresat shoqërore.
 - d) Vendosmëria në vetvete, për të mos u bërë pre e veprave të ndaluara (imoralitetit dhe homoseksualitetit) duke qenë shembull për të tjerët.Nëse zbatohen këto pika, atëherë do të vemë re një frenim të përshkallëzuar ndaj këtyre sëmundjeve. Nuk duhet të mjaftohemi vetëm me trajtimin mjekësor pasi, edhe pse jetojmë në një kohë ku shkenca ka përparuar edhe pse këto sëmundje po marrin trajtimin e duhur mjekësor, përsëri numri i të infektuarve po rritet çdo ditë.

25. A është e vërtetë, se seksi oral, shkakton kancerin në gojë dhe në fytyrë?

Këtë pyetje e kemi dëgjuar shpesh në ligjeratat dhe simpoziumet e mbajtura në shumë vende të botës.

S'ka dyshim se shkenca e mjekësisë, ka vërtetuar se nëpërmjet seksit oral shkaktohen sëmundje të rrezikshme, siç është ajo e kancerit. Kjo sëmundje po shtohet me shumicë në vendet perëndimore.

Meqenëse teknologjia ka përparuar dhe informacionet mbi botën mund ti gjeshe shumë shpejt, kjo na bën të jemi të kujdesshëm ndaj rrjeteve sociale se çfarë përçojnë. Kështu, mënyrat e reja që shfaqen nëpërmjet videove për kryerjen e marrëdhënieve seksuale dhe që janë përhapur anë e mbanë botës, kanë bërë që adoleshentët dhe rinia të largohen nga natyrshmëria e pastër dhe të hulumtojnë në çdo gjë që ia shton atyre kënaqësinë e epsheve. Seksi oral dhe lloje të tjera prej veprave të shëmtuara, jo vetëm që janë shkak i transmetimit të infeksionit tek të tjerët por, janë shkak edhe për mbartjen e sëmundjeve kancerogjene. Ky është një konkluzion që kanë nxjerrë specialistët e fushës së mjekësisë. Për informacion më të detajuar mund të hulumtoni në linkun www.qudah.com

A munden prezervativët të jenë mbrojtës për mos depërtimin e mikrobeve të STIs?

Cila është e vërteta e “seksit të sigurtë”?

Në Perëndim është zgjeruar koncepti i lirisë seksuale si tek adoleshentët dhe të rinjtë ashtu edhe tek të rriturit, duke mos e ndaluar këtë as ligji, as tradita dhe as feja. Ky koncept djallëzor është një çmenduri, fryte të të cilit janë shtimi i sëmundjeve infektive seksuale, në mbarë botën. Për lirinë seksuale janë mbajtur konferenca e ligjërata nga SHBA-ja, duke e prezantuar seksin si ushqim që e kërkon trupi dhe që nuk ka kufi në kryerjen e tij. Ata e mbrojnë këtë ide nën ligjin mbi të drejtat e njeriut. Ata të cilët e projektuan këtë ide nxorrën në pah edhe faktin se mjetet mbrojtëse ju sigurojnë një “seks të sigurtë”. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një shkatërrim për trupin, moralin dhe fenë, duke i shtyrë njerëzit drejt epsheve të pakontrolluara, gjë e cila solli shtimin e sëmundjeve infektive të STIs. Si nga ana shkencore ashtu dhe praktika tradicionale, vërtetohet se nuk ka “seks të sigurtë” veçse në ruajtjen e marrëdhënieve martesore, ashtu siç i ka lejuar Allahu i Madhëruar. Sekretet e Perëndimit në filozofinë e tyre “seks i sigurtë”, është përdorimi i mjete mbrojtëse.

Në vitin 2006 drejtori ekzekutiv për mediat në SHBA njoftoi se, për këtë vit, tetë miliard dollarë do të shkojnë, gjysma për të infektuarit me SIDA dhe gjysma tjetër për përdorimin e mjete mbrojtëse. SHBA-ja në programin e saj ABC në media shpjegon se, kuptimi i fjalës “ndalim” ka si qëllim që, marrëdhëniet seksuale të drejtpërdrejta, për ata që janë të pa martuar, të zëvendësohen me kënaqësinë e të prekurit të organeve gjenitale me dorë ose nëpërmjet seksit oral. Ndërsa kuptimi i fjalës “i sigurtë me partnerin” ka si qëllim që, çdo burrë i cili kryen marrëdhënie seksuale me një grua ose me një burrë (homoseksual) ose marrëdhënie seksuale grua me grua (lesbiket), të jenë të sigurtë ndaj njëri-tjetrit në kryerjen e veprave të turpshme. Ndërsa kuptimi i fjalës (mjete mbrojtës/prezervativë) ka si qëllim, përdorimin e kondomit gjatë seksit jashtmartesor, (imoralitetit, homoseksualitetit) me qëllim ndalimin e depërtimit të bakterieve të sëmundjeve të STIs, sipas pretendimit të tyre.

Por, në të vërtetë, a i ndalon këto mikrobe përdorimi i mjeteve mbrojtëse?

Për këtë ka dy mendime:

Mendimi i parë

Vendet perëndimore e morën të mirfilltë këtë ide dhe e praktikuan atë, duke bërë një tregti fitimprurëse në mbarë botën, me ideologjinë se përdorimi i mjeteve mbrojtëse është një kulturë seksuale, saqë e futën këtë ideologji edhe në tekstet shkollore. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse në Perëndim është bërë si një mjet i domosdoshëm.

Mendimi i dytë

Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nuk është zgjidhje e mirëfilltë. Ajo është zgjidhje e pjesshme. Anëtarë negativë të saj janë më të shumta se anëtarë pozitivë. Për një informacion më të zgjeruar hulumtoni në faqen e internetit www.qudah.com

Nëse ne si specialistë të kësaj fushe pretendojmë se prezervativët janë 100% të sigurtë për mos transmetimin e virusit të SIDA-s, vallë a duhet t'i këshillojmë të rinjtë të përdorin mjete mbrojtëse

në kohën që kryejnë imoralitet!? Kësaj i thonë; po të mbroj nga SIDA dhe po të hedh në zjarrin e ferrit (xhehenemit)!!!

Kështu, programi që jepet në ABC-ja nuk ka mundur të ndikojë në uljen e numrit të të infektuarve. Në dy qytete, në Uashington dhe Nju York, përqindja e numrit të të infektuarve është më e lartë nga të gjitha vendet e botës edhe pse, ata e kanë praktikuar ideologjinë e përdorimit të mjeteve mbrojtëse. Ata të infektuar që i kanë përdorur prezervativët, duke përfshirë këtu si ata që kryejnë imoralitet ashtu edhe ata që janë homoseksualë, kanë deklaruar se kanë hequr dorë nga përdorimi i mjete mbrojtëse dhe i urrejnë për këto arsye:

- i. Ulin kënaqësinë e epshit gjatë marrëdhënieve seksuale.
- ii. Nuk garanton sigurinë mes dy partnerëve.
- iii. Pengon në shkëmbimin e ndërsjelltë të ndjenjave të ngrohta emocionale.
- iv. Disa gra kanë frikë se mos kondomi mbetet brenda në vaginë.
- v. Ndalojnë shtatzaninë ... etj.

Si përfundim theksojmë se, termi “seks i sigurtë“ nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim, i cili në paraqitje të jashtme duket si mjet mbrojtës por që, në fakt është shkatërrim për njerëzimin.

Ndaj duhet të ngrejmë zërin, për të gjithë ato që na dëgjojnë se, nuk ka zgjidhje më të mirë për të gjithë njerëzimin veçse të zbatohet legjislacionin qiellor, njerëzit të rriten me kulturën e kujdesit dhe ruajtjes së ndershmërisë, rregullave të etikës dhe moralit, duhet të mvishen me virtytin e durimit ndaj ambjentit që i rrethon, i cili është i zhytur në problemet e imoralitetit dhe homoseksualitetit.

Gjithashtu, duhet të mbështesim rininë drejt martesës, për të ekuilibruar epshet e tyre. Allahu i Madhëruar në suren El-Enfal: 37, thotë:“(Kjo masë merret) Që ta dallojë Allahu të keqin nga i miri dhe që të verë të këqinj të njërën mbi tjetrin, t'i bëjë grumbull të gjithë e t'i hedhë në ferr (xhehenem). E të tillët janë më të dëshpëruarit.”

Cila është urtësia e ndalimit të homoseksualitetit dhe martesës ndërmjet të njëjtës gjini?

Dijetarë të shumtë myslimanë kanë shkruar libra për temë mbi homoseksualitetin, anët negative dhe se cilat janë urtësitë e ndalimit të tij. Ndërsa, përsa i përket anës shkencore, ndër shkrimet më të bukura për këtë temë veçojmë shkrimin e kryetarit të Shoqatës së Mjekëve Myslimanë në Britaninë e Madhe, që u mbajt në simpozium në vitin 2014, i cili është edhe konsulent i sëmundjeve psikologjike, doktor Mexhid Kuteameh. Ky shkrim përmbante fakte shkencore dhe sociale. Ajo që u theksua më së shumti ishte fakti se marrëdhëniet seksuale midis së njëjtës gjini, në dekadat e shkuara, nuk janë pranuar asnjëherë si një çështje normale prandaj, duhet ta kundërshtojmë atë me të gjitha mënyrat.

Faktet që ai parashtroi janë :

a- Allahu është Fuqiplotë. Ai është Zoti i Musës, Isës, Muhamedit (s.a.a.s). Ai është që krijoi në fillim Ademin si mashkull dhe Havanë (Evën) si femër, për të qënë bashkëshortë për njëri-tjetrin, sipas natyrshmërisë së pastër. Zoti vendosi ndjeshmërinë e forcës së tërheqjes emocionale midis njëri-tjetrit. Shkencërisht është vërtetuar se, në gjithësi ekziston forca tërheqëse midis trupave të kundërt. Lidhja martesore midis mashkullit dhe femrës është një marrëdhënie e ngrohtë emocionale e cila sjell zinxhirin e trashëgimtarëve të racës njerëzore.

Slogani i feve të tjera qiellore se : **“Zoti ka krijuar Adamin e Evën dhe jo Adamin dhe Stivin”** është një slogan shumë i vërtetë. Dmth, marrëdhënia e plotë dhe e natyrshme është ajo midis mashkullit dhe femrës. Feja Islame inkurajon marrëdhëniet bashkëshortore dhe e konsideron atë si mjeti i vetëm, i rregullt, për të kënaqur epshet e njëri-tjetrit.

Allahu i Madhëruar në suren Rum: 30 thotë:

“Përqëndro veten tënde sinqerisht në fe, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fe), feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë”.

Feja islame ndëshkon ata njerëz që sjellin çrregullime në shoqërinë ku ata jetojnë.

b- Allahu i Madhëruar në suren El-A'raf : 189 thotë:

“Ai (Allahu) është Ai që ju krijoi prej një vete, e prej saj krijoi palën tjetër për t'u qetësuar pranë saj. Kur e mbuloi ai (mashkulli) atë (femrën), ajo u ngarkua me një barrë të lehtë dhe ashtu vazhdoi me të, e kur u bë e rëndë, ata të dy lutën Allahun, Zotin e tyre: “Nëse na jep një (fëmijë) të mirë (pa të meta), ne do të jemi falënderues ndaj Teje”.

Profeti Muhammed (alejhis-selam) thotë:

“Kush ka mundësi financiare le të martohet, pasi martesë është mburojë për shikimin, mburojë për organet gjenitale. Ai i cili nuk ka mundësi atëherë le të agjërojë, kjo do të jetë shpëtim për të (më e mirë për të).” Buhariu

Çdo marrëdhënie seksuale me nijetin e martesës, çdo legjislacion dhe çdo sistem i shkollave filozofike të ndryshme është ndërtuar mbi bazat e marrëdhënieve midis dy gjinive të kundërta. S'ka dyshim se kush e ndryshon këtë ligj natyrshmërie, ashtu siç po

veprohet në vendet perendimore (legjitimitetin e LGBT¹), le të presin katastrofën botërore dhe njëkohësisht zemërimin e Allahut dhe ndëshkimin e Tij.

c- Homoseksualiteti dhe imoraliteti nuk janë ndaluar vetëm në fenë Islame por, në të gjitha fetë qiellore. Nëse themi që, homoseksualiteti është një vepër e ndaluar atëherë edhe legjitimiteti i martesës midis tyre është i ndaluar, pasi ajo bie në kundërshtim me të gjitha bazat fetare, tek të gjitha fetë qiellore, bie ndesh me llogjikën dhe traditën. Heshtja ndaj këtyre veprave të ulëta, do ta ballafaqojë njerëzimin me një ndëshkim të dhimbshëm. Allahu i Madhëruar në suren El-Enfal: 25 thotë:
“Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, (por edhe të mirët) dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë“.

Profeti Muhamed (s.a.a.s) thotë:

"Nëse populli im (ndjekësit e mi) do të veprojnë pesë gjëra, atëherë le të presin shkatërrimin;

- i. *Kur të praktikojnë mallkimin.*
- ii. *Kur të praktikojnë pirjen e alkoolit.*
- iii. *Kur burrat të veshin rroba të mëndafshhta.*
- iv. *Kur gratë të këndojnë para burrave të huaj (pra kur këndojnë këngë tërheqëse, erotike)*
- v. *Kur të përhapet dukuria e vetkënaqësisë burrat me burrat dhe gratë me gratë.*
Transmeton Bejhakui

Allahu i Madhëruar ka përmendur ndëshkimin e popullit të Lutit në më shumë se 100 verse në 13 sure të ndryshme (në Kuran).

Allahu i Lartësuar në suren El-Ankebut: 35 thotë:

“E nga ai vend, Ne kemi lënë gjurmë të qartë, për një popull që mendon.”

Suretul Hud: 82-83 thotë:

“Kur erdhi urdhri ynë, Ne i përmbysëm të gjithë ata (fshatrat e tyre) duke kthyer çdo gjë nga lart poshtë, dhe mbi ta hodhëm gurë të fortë pa ia nda. (gurë) Të shënuar te Zoti yt. Ai (vend) nuk është larg zullumqarëve (idhujtarëve kurejshitë).”

Kur homoseksualiteti është specifikuar si një vepër e kryer nga populli i profetit Lut (a.s), që ishin një pakicë njerëzish, dhe mbi ta erdhi ndëshkimi i Zotit me shkatërrimin e qytetit, çarjen dhe përmbysjen e tokës, shi i rrëmbyer duke e fundosur të gjithë popullin, vallë çfarë duhet të themi ne sot? Vallë çfarë ndëshkimi do të na godasë ne sot kur homoseksualiteti është bërë pjesë e bisedave aktuale, është bërë varka e udhëheqjes në rrjetet sociale dhe anija e udhëheqjes në media ?

Disa shoqata në SHBA janë adaptuar me të, disa kuvende parlamentare e kanë bërë pjesë të legjislacionit, duke u mbështetur në ligjin mbi të "drejtat e njeriut". Kjo mbështetje ligjore po i hap rrugën përhapjes masive në të gjithë botën. S'ka dyshim se, njerëzimi do të përballët shumë shpejt me ndëshkimin e Zotit, nëse qëndron kështu indiferent.

Allahu i Madhëruar në suren Hud: 81 thotë:

(engjëjt) Thanë: “O Lut, ne jemi të dërguarit e Zotit tënd. Ata (populli yt) nuk kanë për t'u afruar tek ti, e ti kah fundi i natës udhëto me familjen tënde dhe

¹ LGBT - lezbikë, gej, biseksuale dhe transgjinorë (shën. i përkthyesit)

askush prej jush të mos vështrojë mbrapa. (familja do të shpëtojë) Pos gruas tënde, ajo do goditet me çka do të goditen edhe ata. Afati i tyre është mëngjesi, a nuk është mëngjesi afër?“

d- Studimet shkencore dhe ato mjekësore kanë vërtetuar se homoseksualiteti luan rolin më të madh në përhapjen e sëmundjeve seksuale të STIs dhe sidomos virusit SIDA, i cili është shkak edhe i sëmundjeve kancerogjene. Qendra e kontrollit të sëmundjeve (CDC), në fillimet e shfaqes së SIDA-s, i patën vendosur emrin “Kanceri i homoseksualitetit“, pastaj e quajtën “Dobësimi i sistemit imunitar i homoseksualitetit“ e më pas u quajt SIDA, e cila u klasifikua si një nga sëmundjet e STIs.

Faktet tregojnë se, homoseksualiteti sjell probleme të shumta shëndetësore si kancerin e anusit, duke shkaktuar ulçera dhe humbet qëndrueshmëria e jashtëqitjes. Llojet e sëmundjeve që shkakton homoseksualiteti janë: SIDA, gonerrea, sifilisi, enjtje të organeve gjenitale, herpes, ulçera në vrimën anale, etj. Numri i llojeve të sëmundjeve shkon në 50 e lart.

e- Shkencëtarët kanë vërtetuar se 1/3 e jashtëqitjes janë mikrobe që dalin nga vrima anale. Kështu ajo konsiderohet si pjesa më e papastër e trupit të njeriut. Në vrimën anale, gjenden miliarda bakterie dhe viruse. Kryerja e marrëdhënieve seksuale, në një pjesë kaq të pisët siç veprojnë homoseksualët është jashtë llogjikës, pasi ai është vendi i daljes së mbeturinave trupore.

f- Marrëdhëniet seksuale midis gjinive të njëjta, jo vetëm që, shkaktojnë lloje të ndryshme sëmundjesh shëndetësore por, kjo marrëdhënie e bën njeriun të kalojë në gjendje depresioni, ankthi, stresi, i shkakton djersitje, e shtyn të bëhet përdorues i rregullt i alkoolit dhe ka raste që çon drejt vetrasjes.

g- Allahu i Madhëruar e ka krijuar mashkullin dhe femrën në formën më të bukur, për të plotësuar njëri-tjetrin në të gjitha fushat e jetës. Për të kënaqur epshet e tyre Ai ju siguroi kënaqësinë nëpërmjet organeve gjenitale, të gjinive të ndryshme, duke u kurorëzuar me martesë. Kjo lloj marrëdhënie midis mashkullit dhe femrës, i jep kënaqësinë e plotë emocionale, ku përputhen natyrshmëria seksuale dhe marrëdhënia e singertë tek partnerët. Kjo marrëdhënie mbushet me dashuri, qetësi e mëshirë ndaj njëri-tjetrit.

Allahu i Lartësuar në suren El-Bekare: 223 thotë:

“Gratë tua ja janë vendmbjellja juaj, afrojuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por përgatitni (vepra të mira) për veten tuaj, dhe kini frikë Allahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepu lajm të mirë (myzhde).”

h- Studimet mjekësore kanë vërtetuar se, rritja më e mirë e një fëmije si nga ana trupore, fizike dhe psikologjike, është rritja e tij në krahët dhe prehërin e prindërve. Kjo arrihet vetëm kur nëna dhe babai i ofrojnë fëmijës një ambient të mbushur me qetësi, dashuri, dhe stabilitet. Feja Islame i udhëzon njerëzit drejt kësaj fryme edukimi, për të pasur pasardhës dhe një shoqëri me vlera.

i- Prej të drejtave të fëmijës është të jetojë një jetë të qetë e mbushur me dashuri, pranë prindërve që e kanë lindur dhe jo mes atyre që e kanë birësuar, ashtu siç veprojnë

homoseksualët, të cilët nuk posedojnë ndjenjat emocionale dhe ngrohtësinë që kanë prindërit biologjik. Ata i birësojnë fëmijët me qëllim që, një ditë, këta fëmijë tu shërbejnë atyre. A nuk është kjo një padrejtësi që u bëhet fëmijëve, gjë të cilën feja islame nuk e pranon? Nëse në vendet perëndimore e justifikojnë homoseksualitetin si liri personale e individit, si e drejtë prej të drejtave të njeriut, atëherë çfarë duhet të themi për miliona fëmijë të cilëve u janë dhunuar të drejtat e tyre??? Ku janë shoqatat sociale që mbrojnë të drejtat e njeriut, që nuk i frenojnë këto padrejtësi ndaj të drejtave të fëmijëve?

j- Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun që ta adhurojë Atë, për të qenë mëkëmbës (i Zotit) në këtë gjithësi dhe i vendosi atij legjislacionin më të plotë e fisnik e më të dobishëm për të gjithë njerëzimin (ligjet Kuranore).

Në suren Mulk: 14 Allahu i Madhëruar thotë:

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë“ ?

Për dobinë dhe mirësinë e njerëzimit, për tu plotësuar ky njeri, Zoti vendosi martesën për tu formuar familja e për të pasur pasardhës, djem e vajza, në mënyrë që të vazhdojë e të zhvillohet rraca njerëzore.

Profeti Muhamed (s.a.a.s) ka thënë:

-“Martohuni, shtohuni dhe lini pasardhës! Në të vërtetë unë do të jem krenar për ju ditën e ringjalljes“ Transmeton Bejhakui

Martesa midis të njëjtës gjini nuk i plotëson kushtet për të lindur e për të pasur pasardhës por, ajo është bazë e shfaqes së shumë sëmundjeve të ndryshme, që e çojnë shoqërinë drejt shkatërrimit. Ndaj edhe feja Islame e ka ndaluar dhe e ndëshkon atë njeri që e praktikon këtë vepër.

Çdo inkurajim dhe çdo mbështetje apo reklamim ndaj kësaj veprë të shëmtuar nuk është gjë tjetër veçse, mbështetje ndaj veprave të shëmtuara e të turpshme.

Ajo është shkatërrim për shoqërinë për këto arsye:

- i. Homoseksualiteti është kundër martesës normale natyrale e cila praktikohet nga mbarë njerëzimi.
- ii. Ajo çon në probleme psikologjike tek fëmijët.
- iii. Ajo kundërshton të gjitha llojet e feve qiellore (Islamin, Hebraizmin, Krishterimin).
- iv. Ajo është në kundërshtim me bazat e etikës e të moralit.
- v. Ajo është rrezik për shoqërinë.
- vi. Ajo është rrezik për shëndetin.
- vii. Ajo është kërcënim për njerëzimin, qetësinë dhe vazdimësinë e racës njerëzore.

Feja Islame, e ndalon çdo gjë që është në dëm të njerëzimit dhe të shkatërrimit të shoqërisë, siç është përballja me këto sëmundje infektive të STIs.

Referencat:

1. http://www.unaids.org/en/media/unaids/contentassets/documents/epidemiology/WorldAIDSday_results_en.pdf

1. Sëmundjet seksuale një ndëshkim i madh. (Dr. Abdul Hamid El-Kudah). 2008- Aman- Jordani.
2. Broshura e kongresit botëror për banorët dhe rritja e nivelit të tyre. USA .1994- Kajro.
3. Vizioni islam në përballjen e AIDS. Shoqata e dijetarëve sipas legjislacionit islam. 2008-Aman- Jordani.
4. Vizioni i seksit midis islamit dhe orientalistëve. (Hafiz, Jusuf Musa Ebu El-Esbat). 1988- Rijad.
5. Sëmundjet seksuale, shkaqet dhe mjekimi i tyre. (Muhammed Ali El-Bar). 1985- Xhideh.
6. Populli i Lutit me një mantil të ri. (Dr. Abdul Hamid El-Kudah). 2007- Aman- Jordani.
7. Problemet e rinisë nga ana emocionale, seksuale nën dritën e legjislacionit islam. (Abdu Err-Rahman Wasil). 1981-Xhideh.
8. King K. Holmes and others, Sexually Transmitted Diseases. (New York, MC Graw Hill Companies, 1999),1.
9. Hariri, S, et, al. Prevalence of genital, human papillomavirus amonge females in the United States the National Health, Survey and Nutrition Examination Survey 2003-2006. And The Journal of Infectious Diseases Aug 15- 2011. pp 566-73.
10. Research Cancer Research UK. Risks and causes of penile cancer
11. [Online MARCH 5, 2014 [http. // www. Cancerre. Searchuk.org/ cancer- help/ type/penilecancer/ about/ risks- and—causes- of-penile- cancer](http://www.Cancerre.Searchuk.org/cancer-help/type/penilecancer/about/risks-and-causes-of-penile-cancer).
12. Jawetz, Melnich. and Adelberg Medical Microbiology London Appleton and Lange Norwalk 1995. 273
13. [www. who. Int/ SexuallyTransmitted Infections](http://www.who.int/SexuallyTransmittedInfections), Fact sheet No 110.NOV.2013.
14. Joint United Nations. Program on HIV /AIDS (UNAIDS). The male condom: UNAIDS technical update. Geneva: UNAIDS-2000.
15. Canto, MT and Devesa SS. Oral cavity and pharynx cancer incidence rates in the United States 1975-1998. Oral Oncol 2002.pp,610-617.
16. Schantz, SP and Yu, GP. Head and neck cancer incidence trends in young Americans 1973-1997, with a special analyses for tongue cancer. Arch Otolaryngol Head Neck Surg. 2002 pp,268- 274.
17. [www. straightdope. com./ columns/ read/1178/ The Straight Dope: Can HIV pass through the pores in latex condoms?](http://www.straightdope.com/columns/read/1178/TheStraightDope:CanHIVpassthroughtheporesinlatexcondoms) May. 6 1994
18. Green Edward C, Broken Promises: How the AIDS Establishment has betrayed the developing countries PoliPointPress, LLC,2011,80 Libertyship way, suite 22, Sansaleto, CA94965.
19. Ani K. Chaturvedi, Eric A. Engels William F. Anderson, and Maura L Gilson. Incidence Trends for Human Papillomavirus- Relatedand- Unrelated Oral Squamous Cell Carcinomas in the United States. JOURNAL OF CLINICAL ONCOLOGY. FEBRUARY 1, 2008, pp. 612-619.

20. Hammarstedt L, Lindquist D and Dahlstrand, H Human papillomavirus, as a risk factor for the increase of tonsillar cancer. International Journal of Cancer. 2006, pp. 2620-2623.
21. UNFPA. 2007 report on donor portsup for contraceptives and condoms for STI /HIV prevention 2007
22. Jeremy Laurance, Calls to immunise teenage boys after huge rise in throatcancer” <http://www.independentin.co.uk>. retrieved on November.2- 2013, <http://www.independentin.co.life-stile/health-and-families/healthnews/6292679.html>.
23. Joint United Nations Program on HIV/AIDS (UNAIDS). The male condom: UNAIDS technical update. Geneva: UNAIDS, 2000.
24. Green Edward C, Rethinking AIDS prevention: Learning from succses in developing countries, Prager publishers 2003,88 Post Road West, Westport, CT06881.
25. Keating, Fiona. Increase in Mouth Cancer Caused by` Catastrophic Rise in Oral Sex. October 19, 2013.
26. American Society for Colposcopy and Cervical Pathology. Colposcopy: Colposcopic Appearance of High- Grade Lesions. January 4, 2012.
27. Shows Research New-"org.colfi.www. colfi.org" New Research Shows Dangers of Condoms in HIV Prevention – “. Culture & Cosmos, 13.jan 2004, vol 1, No23.
28. Chaturvedi, AK, Engels, EA and Pfeiffer, RM. Human papillomavirus and rising oropharyngeal cancer incidence in the United States. Journal of Clinical Oncology. 2011, pp. 4294- 4301.
29. Blot, WJ, Devesa, SS, and McLaughlin, JK. Oral and pharyngeal cancers Cancer Surv. 1994, pp 23- 42.
30. Gypsyamber D` Souza, Ph. D & Others. Case – Control Study of Human Papillomavirus and Oropharyngeal Cancer. THE NEW ENGLAND JOURNAL OF MEDICINE. 10 May, 2007, 356, pp.1944- 1956.
31. Oral sex can cause throat cancer. Khamsi Roxanne. 09 May 2007, New Scientist.
32. Condoms and HIV prevention: Position statement by UNAIDS, UNFPA and WHO 19 March 2009.
33. Pinkerton SD et al, Effectiveness of condoms in preventing HIV- transmission. SocSci Med. 1997 May 44(9) 1303- 12.
34. WellerS, DavisK. Condom effectiveness in reducing heterosexual HIV transmission. Cochrane Database Syst Rev. 2002(1) CD00325.
35. [www.cdc.gov/condoms&their use preventing HIV infection & other STIs](http://www.cdc.gov/condoms&their%20use%20preventing%20HIV%20infection%20&%20other%20STIs), Sep 1999.
36. Sanders SA et al, Condom use errors and problems: a global view.sex. Health. 2012 Feb 17;9(1) 81- 95.
37. 28 .95-81):1(9;17 Feb 2012.Health /News/ke.co.theeashrafrican.www.theeashrafrican.co.ke/News/ UNAIDS and the myths of condom efficacy against AIDS- / 2558.
38. Ward H et al, Contribution of sexually transmitted infections to the sexual transmission of HIV. Curropin. HIV/ AIDS. 2010,5 JUL (4) 305-10.
39. National institute of Allergy and Infectious diseases (NIAID). Scientific evidence on condom effectiveness for sexually transmitted diseases (STD)prevention. NIAID 2001.
40. www.who.int/Sexually Transmitted Infections, Fact sheet No 110, August 2011.

41. Bradshaw Steve, Condoms Don't Stop AIDS- Vatican the Guardian- UK10-9-2003.
42. <http://www.guardian.co.uk/aids/story/0,7369,1059068,00.html>.
43. CDC.Updated Fact Sheet: HIV in the United States: At A Glance, HIV.Website. Published 4 December, 2013.
44. Norman Hearst. SannyChen, Condom Promotion for AIDS Prevention in the Developing World: Is it Working? Studies in Family Planning, Volume 35, 1 Issue, pages 39-47, March 2004.
45. HIV Declining, al et K Flykesnes K et al, Declining HIV prevalence and risk behaviors in Zambia: evidence from surveillance and population based surveys. AIDS 2001; 15: 507-16. (Pub Med).

Përmbajtja e Lëndës

Parathënie.....	2
Fjala e përkthyesit.....	3
Kuptimet e simboleve të përdorura.....	4
Fakte dhe statistika mbi STIs, HIV & AIDS	5
Sëmundjet seksualisht transmetuese infektuese (STIs).....	16
Pyetje & Përgjigje.....	16
A munden prezervativët të jenë mbrojtës për mos depërtimin e mikrobeve të STIs?	23
Cila është e vërteta e “seksit të sigurtë”?	23
Mendimi i parë	23
Mendimi i dytë	23
Cila është urtësia e ndalimit të homoseksualitetit dhe martesës ndërmjet të njëjtës gjini?.....	25
Referencat:	29